

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



PUNIM DIPLOME - MASTER

TEMA :

VLERËSIMI I DISA AFTËSIVE THEMELORE ANTROPOMETRIKE, TË MOTORIKËS
BAZIKE DHE MOTORIKËS SITUACIONALE NË VOLEJBOLL ME NXËNËSIT
E KLASËS SË NËNTË (14 – 15 VJEÇ)

MENTORI :
Dr.sc. Musa SELIMI

KANDIDATI:
Fidan TMAVA
Vllaznim SHABANI

PRISHTINË 2017

PERMBAJTJA

1. HYRJE	3
2. DISA HULUMTIME TË GJERËTANISHME	5
3. QËLLIMI I PUNIMIT	9
3.1. Hipotezat themelore	10
4. METODAT E HULUMTIMIT	11
4.1 Mostra e entiteteve	11
4.2 Mostra e ndryshoreve	11
4.2.1 Variablat antropometrike	12
4.2.2 Variablat motorike	12
4.2.3 Variablat situacionele	12
4.3 Kushtet, instrumentet, dhe teknikat e matjes	13
4.3.1 Përshkrimi i procedurave të matjes së variablave antropometrike	15
4.4 Metodatat statistikore të përpunimit të rezultateve	26
5. REZULTATET DHE DISKUTIMI	27
5.1 Parametrat themelor statistikor	27
5.1.1 Analiza e parametrave themelor të ndryshoreve antropometrike dhe motorike	27
5.2 Korelacionet ndërmjet ndryshoreve antropometrike, motorike dhe motorike situacionale	39
5.2 Ndryshimet ndërmjet grupeve për variablat antropometrike, motorike dhe specifike	43
5.1 Analiza e hipotezave	46
6. PËRFUNDIMI	47
7. LITERATURA	48

1. HYRJE

Njeriu si qenje biopsikosociale i cili në jetën e përditëshme në mesin ku jeton, vepron dhe krijon, krahas zhvillimit të shkencës, teknikës dhe kulturës, rëndësi të madhe duhet t'i kushtoj edhe shëndetit të tij.

Me anë të edukatës fizike (sportit) të nxënësve duhet të ndikohet në formimin e cilësive pozitive të karakterit pavarësisht në veprime, të vendosshmërisë, guximit si dhe në raste e në situata siç janë: këmbngulësia, përballimi i dobësive personale (frika, dhimbja) duke u bërë kështu personalitet i kompletuar. Përmes aktiviteteve në edukatën fizike dhe sportive ne ndikojmë drejtëpërsëdrejti në zhvillimin sistematik të nxënësve duke zhvilluar ndjenjën e guximit, përballimit të frikës, marrëdhëniet e bashkpunimit, të respektit, socializimit, etj.

Volejboli është sport i ardhmërisë. Ai pandërprerë zhvillohet, përshtatet dhe gjenë modele të reja atraktive të organizimit. Për nga struktura e lëvizjeve volejboli bënë pjesë në grupin e sporteve polistrukturale komplekse. Elementet e lojës së volebollit ngërthejnë në vete detyra të kombinuara dhe mjaft të ndërlikuara ndërmjet aftësive motorike me lëvizje dhe veprime të ndryshme e të shpejta, kërcime të larta si dhe duele të ndryshme në ajr (mbi rrjetë) me kundërshtar si në sulmë ashtu edhe në mbrojtje.

Përmes lojës arrihen ndryshime të veçorive antropologjike si të atyre ndërtuese të dijës intelektuale dhe vullnetit e sidomos atyre motorike.

Nëse përqëndrohemi në zhvillimin e volebollit bashkëkohor, vërejmë se si gjithnjë e më shumë dominon shpejtësia e reaksionit, e aksionit, forca eksplozive, lëvizshmëria, koordinimi, pastaj në aspektin antropometrik rol të madh tani luan edhe gjatësia, mosha, pesha etj., që ndikojnë në lojë. Si lojë sportive në gjirin e saj rol të rëndësishëm zënë: teknika, taktika, aftësitë psiko-motorike pa të cilën loja nuk do të ishte interesante, atraktive, estetike dhe sportive-garuese me një fjalë.

Volejboli me zhvillimin e vet dinamik si sport në familjen e sporteve kolektive, shtynë ekspertët dhe pedagogët tek ne dhe më gjerë, që të merren me volejbollin dhe me ngritjen e tij të mëtutjeshëm. Sot ndihet mungesa e literaturës së specializuar sportive në Kosovë që shumë trajnerë dhe pedagogë, për një periudhë të gjatë kohore e ndjejnë nevojën e saj posaçërisht në volejball.

Andaj, në këtë punim do të mundohem ti trajtoj disa karakteristika të volejbollistëve kulminant, dhe për të realizuar një gjë të tillë është ma se e nevojshme që punën ta vë mbi baza sa më profesionale-shkencore-kërkimore dhe praktike me qëllim që trajnerëve dhe lojtarëve të këtij sporti nëpër klube dhe shkolla të volejbollit tu japim shprehje të punës (teorike dhe praktike) të mbështetura mbi volejbollin kulminant botëror (bashkëkohor). Duke u mbështetur mbi informacionet (statistikore), punën, metodat dhe të tjera, të nxjerra nga ne dhe nga analizat e ekspertëve të ndryshëm të volejbollit, të cilët janë ballafaquar me arritjet e këtij sporti, ishte tani koha që të bëhet një ndarje, sistematizim, shikim, analizë rreth zhvillimeve më të fundit të volejbollistëve kulminant botëror. Zhvillimi i vrullshëm i volejbollit dhe mosndjekja në kontinuitet e këtyre ndryshimeve siç është rasti me lojtarët kulminant e shpie volejbollin Kosovar në ngecje dhe praktikisht kjo do të thotë se ne e humbim hapin për t'u inkuadruar dhe analizuar në atë që ndodhë në volejbollin Evropian dhe Botëror, pa të cilën nuk ndërtohen as standardet e kërkuara nga ne dhe për ne.

2. DISA HULUMTIME TË GJERËTANISHME

Duke u bazuar në qëllimin e këtij hulumtimi jemi munduar që literaturën e shqyrtuar ta paraqesim sa më të përafërt me temën e këtij punimi. Hulumtimet në sportin e volejbollit janë të shumta si në rrethin ndërkombëtar ashtu edhe në atë kombëtar, por ndryshon tematika dhe mostra e të testuarve. Në këtë punim do të paraqiten disa prej punimeve të autorëve të ndryshëm kombëtar e ndërkombëtar duke filluar nga viti i mëhershëm.

A. Strahonja (1974) ka vërtetuar, në mostrën prej 126 volejbollistëve junior të moshës 18-20 vjeçarë, të nxjerrë kryesisht nga volejbollistët e reprezentacioneve republikane që matjet antropometrike të dimenzioneve longitudinale dhe cirkulare kanë rëndësi në kontributin e rezultateve prediktive të kërcimit specifik dhe kapjes së topit në lartësi maksimale të volejbollistit. Në fushën manifeste është fituar korrelacion i rëndësishëm multidimensional prej .55, për pasqyrimin e gjatësisë .76, për lartësinë e kapjes së topit në kërcim. Në hapësirën latente është përfituar korrelacion i rëndësishëm multidimensional prej .37 për lartësinë e kërcimit dhe .66 për lartësinë e kapjes së topit në kërcim.

Ivaljov A. (1974), bënë hulumtimin me “ volejbollistët e rinj, prej 8-18 vjeçarë “, vërteton se gjatësia e trupit është më rëndësi të madhe dhe si faktor kryesor për sukses në lojën e volejbollit. Volejbollistët e tij, si mostër, kanë përparësi sa i përket gjatësisë së trupit por perimetri i gjoksit është diç më i vogël, gjë që është një lloj treguesi se volejbollistët bëjnë pjesë në grupin e ashtuquajtur të tipit “leptozom“, që kanë ekstremitete të gjata, trup të gjatë, kurse perimetri i trupit dhe ekstremiteteve është më i vogël.

Gjinolli E. (1977). Në tezen “ Karakteristikat antropometrike dhe motorike të vlefshme për volejboll, te nxënësit e klasës së pestë fillore“. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi kanë qenë karakteristikat kryesore antropometrike dhe motorike të nxënësve si dhe orientimi-seleksionimi i tyre për volejboll. Në faktorizimin e hapësirës antropometrike janë izoluar dy dimensione latente antropometrike, kurse në faktorizimin e hapësirës motorike janë izoluar tri dimensione latente motorike.

M. Gabrijeliç (1977) ka hulumtuar, në mostrën prej 222 sportistëve kulminant të rangut federativ, të moshës 18-25 vjeçare³, anëtar të kategorisë së sporteve mashkullore, basketboll (54), futboll (52), volejboll (58), hendboll (58), lidhmëria e dimensioneve manifeste latente, të përgjithshme dhe specifike motorike, kognitive dhe konative me sukses në secilën lojë sportive posaçërisht, atë e ka bërë analizën komparative të lojërave sportive. Janë përdorur 16 teste universale në të gjitha grupet e të testuarve dhe atë nga tre teste specifike situacionale për secilën lojë sportive. Aftësitë e volejbollistëve kulminant në krahasim me sportet tjera janë renditur si në vazhdim. Volejbollistët janë superior në forcën eksplozive të këmbëve dhe duarve, kurse inferior në shpejtësinë e vrapimit. Përveç kësaj të gjitha dimensionet manifestuese të neurotizmit gjeneral të volejbollistët janë më se paku të shprehura në raport me tri lojërat tjera sportive.¹

G. Çomashi (1982), në mostrën prej 184 meshkujve të moshës 18-27 vjeçare të cilët i janë nënshtruar testit për pranim në fakultetin e kulturës fizike në Zagreb, ka kryer 7 teste motorike dhe 5 teste për vlerësimin e përvetësimit të disa elementeve bazike të volejbollit. Me analizën regresive është vërtetuar vlerë e rëndësishme prediktive por jo edhe e lartë e 2 testeve motorik : force eksplozive (kërcim në largësi) agjiliteti (shpejtësia e levizjes) për sukses në ekzekutimin e elementeve bazike të volejbollit.

Çitaku, F. (1981) ka bërë hulumtim me 118 sportistë aktivë (hendbollistë, basketbollistë dhe volejbollistë) të ligës së Kosovës dhe asaj federative. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi ka qenë përcaktimi i strukturës faktoriale të ndryshoreve të zbatuara, përcaktimi i mes lidhjeve faktoriale në hapësirën manifeste dhe latente, varësisht nga tri grupet e sportistëve. Në bazë të analizës të të dhënave janë emëruar këta faktorë të

¹ Doktorska disertacija , FFK , Sveuciliste u Zagrebu , Zagreb 1977

rëndësishëm: faktori parë është definuar si kombinim i forcës përsëritëse (repetitive) dhe statike; faktori i dytë është definuar si forcë eksplozive, faktori i tretë është emëruar si kombinim i forcës statike, në rend të parë dhe asaj përsëritëse (repetitive) në rend të dytë. Është konstatuar se preciziteti nuk është ekstrahuar si faktor.²

Strahonja, A., - Jankovic, V. Dhe Shnajder, V. (1982), në mostrën prej 45 studentëve të FKF- së në Zagreb, të cilët e kanë dhënë provimin e volejbollit me notë të mirë, vlerësuan besueshmërinë dhe validitetin faktorial të 24 testeve situacionale-motorike në volejball. Është vetëtuar hipoteza prej 7 faktorëve situacionalo-motorikë që interpretohen; preciziteti i dëbimit dhe goditja mbi top, shpejtësia e qëndrueshmërisë (besueshmëria ishte e vogël) e volejbollistëve dhe lëvizjet e shpejta të volejbollistëve.

Kelneriç D. (1982) , në mostrën prej 64 femrave të moshës 18-20 vjeçare, të cilat i janë nënshtruar testit për pranim në fakultetin e kulturës fizike në Zagreb⁴, ka realizuar 7 teste për vlerësimin e dimensioneve motorike dhe 5 teste për vlerësimin e përvetësimit të informacioneve bazike motorike të volejbollit. Relacioni ndërmjet këtyre dy variablave të mbledhura është vërtetuar me analizen regresive dhe kanonike. Korelacioni i llojit të parë të faktorëve kanonik ka qenë i definuar në hapësirën motorike të testeve të fleksibilitetit, forcës eksplozive , agjilitetit dhe forcës repetitive , e në fushën e elementeve të volejbollit në përfitimin e ekzekutimit të teknikës. Korrelacioni i llojit të dytë do të mund t'i përshkruhej mekanizmit të strukturimit të lëvizjeve , të përfitimit të teknikës së dëbimit me çekan. Në analizën regresive, majës se dëbimit prediktiv i kanë paraprirë testet e dedikuara për vlerësimin e fleksibilitetit dhe agjilitetit, parashikimit të rezultateve të dëbimit të ulët të testeve të agjilitetit , kurse parashikimit të shërbimit nga dyshemeja testet për vlerësimin e baraspeshës.³

² Disertacion doktrate, FFK, Zagreb, 1977.

³ Magistarski rad, FFV, Beograd, 1983/

Lukaq L. (1983), hulumtoj karakteristikat morfologjike dhe motorike të volejbollistëve në Bosnje dhe Hercegovinë, duke përfshirë pesë nivele garash. Grupi i të testuarve ka qenë i përbërë prej 150 volejbollistëve. Autori aplikoj 10 variabla, pesë nga motorika dhe pesë nga antropometria.

Mr. Geci, B. (2000), në punimin e magjistraturës të realizuar me 7 klube të ligës së parë të Kosovës në volejboll me 71 volejbollistë (meshkuj) hulumtoi fushën antropometrike dhe motorike. Në këtë punim janë aplikuar pesë ndryshore antropometrike dhe gjashtë ndryshore motorike, prej tyre tri situacionale me këta volejbollistë. Në ndryshoret antropometrike janë trajtuar me procedurë faktoriale dhe janë ekstrahuar dy faktorë, ndërsa në ndryshoret motorike janë izoluar tri dimensione latente motorike. Në dimensionin antropometrik koficientët më të lartë të korrelacionit janë arritur në mesë të variables pesha e trupit me variablat tjera prej (.55-.46). Që tregon grupëzimin për vlerësimin e dimensionit të masës dhe të vëllimit të trupit. Kurse variablat lartësia e trupit, pasha e trupit dhe gjatësia e krahut kanë koeficient të lartë të korrelacionit në mes tyre (.63-.53). Këto variabla tregojnë grupëzimin për vlerësimin e dimensionit longitudinal të skeletit. Ndërsa variablat lartësia e trupit dhe gjatësia e krahut si parametra antropometrik janë mjaftë të rëndësishëm për volejbollistë.⁴

Selimi, M. (2004), në punim (disertacionin e doktoratës), shtjellon më detalisht për lojtarin e mbrojtjes të ashtuquajtur të lojtarit “libero”. Në këtë punim ka hulumtuar ku ka shqyrtuar të arriturat si në aspektin teknik, taktik, psiko-motorik dhe po ashtu edhe të vendosjes të lojtarit “libero”.

⁴ Punim magjistrature, Besnik Geci, Prishtinë, faqe 8, 2000.

3. QËLLIMI I PUNIMIT

Qëllimi i hulumtimit është që të konstatohet gjendja momentale e aftësive themelore të këtyre nxënësve të klasës IX-ta (nënta) të moshës 14-15 vjeç edhe pse kjo moshë është mjaftë delikate dhe e ndërlikuar për hulumtim, pasi që siç dihet kjo moshë përkon me kohën e ndryshimeve të mëdha që ndodhin në organizmin e fëmijës (adoleshenca) me ç'rast edhe rezultatet e treguara mund të jenë momentale, megjithatë mund të ndokojë që disa nga këta të rinjë të merren aktivisht me sport dhe aktivitet fizike edhe pse moshë e adoleshencës nuk është barometër i mirë i seleksionimit të sportitstëve kualitativ (është paksa e vonuar). Ndërsa qëllimi kryesor i këtij punimi është konstatimi i ndryshoreve në parametrat:

1. Antropometrike
2. Motorike bazike
3. Motorike situacionale

ndërmjet nxënësve të të njëjtës moshë dhe gjini të dy qytetëve të ndryshme të Rajonit të Rrafshit të Kosovës (Vushtrri dhe Lipjan) .

Qëllimi i këtij punimi mbështetet në fuqizimin e vërtetimit të ligjshmërive të rëndësishme për arritjen e rezultateve cilësore në lojën e volejbollit.

Njohja e parametrave përshkrues të nxënësve të trajtuar si dhe shpërndarja e rezultateve të grupit në parametrat antropometrike, motorike dhe situacionale në këtë punim.

Përcaktimi i lidhshmërive të vlefshme në mes ndryshoreve antropometrike, motorike dhe situacionale.

Trajtimi i lidhshmërive brenda hapësirës antropometrike gjithashtu edhe hapësirës motorike.

Qëllim tjetër në këtë punim është edhe ndryshimet ndërmjet nxënësve të dy komunave si dhe ndryshimet ndërmjet gjinisë femrore dhe mashkullore.

3.1. Hipotezat themelore

H1. – Pres që do të paraqiten lidhmëri të rëndësishme në mes variablave antropometrike dhe motorikës bazike.

H2.– Nuk presim se do të paraqiten raporte të rëndësishme korelative ndërmjet antropometrisë dhe motorikës situacionale.

H3.- Presim ndryshime të vogla të antropometrisë dhe motorikës bazike të nxënësve në mes të dy shkollave të qyteteve (Vushtri dhe Lipjan).

4. METODAT E HULUMTIMIT

4.1 Mostra e entiteteve

Në këtë hulumtim janë përfshirë 80-të nxënës më të shëndetshëm në aspektin fiziologjik të dalluar në orën e edukatës fizike prej të cilëve 40-të meshkuj dhe 40-të femra të 3 shkollave të qytetit të Vushtrrisë dhe gjithashtu janë përfshirë 80 nxënës prej të cilëve 40-të meshkuj dhe 40-të femra nga qyteti i Lipjanit. Këta nxënës i takojnë shkollave që nuk kanë traditë në lojën e volejbollit. Në këtë hulumtim parashihet të zgjedhen nxënës të cilët nuk janë aktiv në asnjë sport përveç orës së edukatës fizike dhe sportive si dhe aktiviteteve të lira shkollore.

4.2 Mostra e ndryshoreve

Duke u bazuar në qëllimin e hulumtimit janë përfshirë 11 variabla prej të cilave katër janë antropometrike, katër motorikë bazike (themelore) dhe tri të motorikës situacionale.

4.2.1 Variablat antropometrike

1. APESHA – pasha trupore
2. ALARTE – lartësia trupore
3. AGJSHP – gjatësia e shputës
4. AGJAKR – gjatësia e krahëve të shtrirë

4.2.2 Variablat motorike

1. MKLVEN – kërcim së larti nga vendi
2. MKGJVE – kërcimi së gjati nga vendi
3. MVR20M – vrapim 20 metra
4. MGT500 – gjuajtja e tophave 500g në largësi nga vendi

4.2.3 Variablat situacionele

1. MSSHTO - shërbimi i topit
2. MSGJKE – gjuajtja me kërcim
3. MSPRTO – pranimi i topit

4.3 Kushtet, instrumentet, dhe teknikat e matjes

Të gjitha matjet janë realizuar gjatë orëve të edukatës fizike të nxënësve në sallën e edukatës fizike dhe poligonin sportiv.

Para startimit të procesit matës çdo nxënësi i është dhënë verbalisht informatë për pikat matëse dhe nga ana e matësve është demonstruar pozita e qëndrimit gjatë matjes. Është treguar qëllimi i matjes, në mënyrë që mos të krijohet huti gjatë procesit matës dhe që nxënësit të jenë sa më të lirë në ekzekutim.

Matjet i ka bërë grupi i kolegëve të studimeve të cilët kanë pasur njohuri paraprake për teknikat e matjes.

Të ekzaminuarit gjatë matjeve të parametrave antropometrik kanë qenë këmbëzbathur të veshur vetëm me veshje sportive.

Matja e parametrave antropometrik është bërë gjatë mesditës prej orës 11,00 deri ora 13,00 në hapësirën e cila ka qenë mjaftë e ndriçuar dhe në të cilën temperatura ka qenë në kufijtë e normales, prej 17 deri 22 C.

Për testimin e ndryshoreve motorike janë shfrytëzuar procedurat standarde dhe valide të testimit. Instrumentet kanë qenë të standardizuara dhe të bazhduara para fillimit të matjes dhe gjatë matjes. Nga ana e nxënësve këto matje janë pritur me interesim të madh e sidomos kërcimet dhe vrapimi.

Instrumentet antropometrike janë përdorur ato të mundshme matjen e parametrave antropometrik. Testet motorike ku është vlerësuar me ndihmën e disa pajisjeve të domosdoshme me të cilat duhet të bëhet matja:

- peshorja, me saktësi të matjes prej 0,1 kg,
- kronometri digjital
- shiriti metrik dhe plastik
- konat plastik,
- ngjitës i letrës,

Instrumentet matëse



Foto 1 - Pajisjet antropometrike



Foto 2 - Peshorja



Foto 3 - Kronometri



Foto 4 - Shiriti matës

4.3.1 Përshkrimi i procedurave të matjes së variablave antropometrike

PESHA E TRUPIT

Mjetet: Peshorja decimale.

Personin të cilin e masim, duhet të jetë i zbathur dhe vetëm në brekë dhe duhet të qëndroj në pozitën normale të drejtë – në mesin e peshojës.

Peshorja duhet të jetë e vendosur në sipërfaqe të rrafshët, dhe të kontrollohet pas çdo matje.

Rezultati në fletëtestin përkatës shënohet, me saktësi 0.5 kg.



Foto 5 - PESHA E TRUPIT

LARTËSIA E TRUPIT

Mjetet e punës: antropometri sipas Martinit.

Subjektin të cilin e masim qëndron në pozitën drejt i zbathur, mirëpo matja e nxënësve bëhet zbathur për arsye të përshtatjes, prekjes që bëhet në situata të lojës.

Sipërfaqja e dyshemesë në të cilën bëhet matja, duhet të jetë e fortë dhe e rrafshët.

Antropometri vendoset në pozicionin vertikal, përgjatë boshtit kurrizorë të nxënësit nga ana e pasme.

Subjekti qëndron anash subjektit të cilin e masim, në pozitën e drejt vertikale, deri në momentin kur nxënësi vendoset – lëshohet centimetri mbi kokë, dhe kur ai e prekë majën e kokës së subjektit, bëhet leximi i rezultatit.

Rezultati në fletëtestin përkatës shënohet në vlerën e rrumbullakët të numrit të milimetrave, me saktësi 0.5 cm .



GJATËSIA E SHPUTËS SË KËMBËS

Mjetet: antropometri i shkurtuar.

Gjatësia e shputës matet me antropometër të shkurtuar. I maturi qëndron ulur me këmbën e majtë të mbledhur që formon këndin e drejtë dhe me shputë vendosur në dysHEME. Matësi ia vendosë krahët e antropometrit në thembër dhe në gishtin më të gjatë, (thonjtë duhet të jenë të prerë). Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1cm.



GJATËSIA E KRAHËVE SHTRIRË

Kjo është distanca ndërmjet dorës së majtë dhe të djathtë kur jemi të mbështetur në murë. Për të parandaluar gabimet potenciale për shkak të kraharorit të madh, subjekti qëndron me shpinë të mbështetur për muri. Duart e zgjeruara anash duhet të jenë në pozitë horizontale. Shpesh është dobiprurëse që të përdorim këndin (qoshin) e murit të dhomës për njërën anë dhe pastaj në anën tjetër të bëjmë matjen, është e nevojshme të bëhet vetëm një shenjë në mur - dërrasë. Shiriti matës antropometrik përdoret për të bërë matjen e gjatësisë së shtrirjes së krahëve.



4.3.2 Përshkrimi i procedurave të matjes së variablave motorike

KËRCIM SË LARTI NGA VENDI

Me këtë test masim forcën eksplozive të muskujve.

Mjetet: Shkumësi, apo stilolapsat me ngjyrë, shiriti metalik në centimetra.


Shkëputja kryhet nga vendi me të dy këmbët. Janë të lejuara lëvizjet e hovit me duar, dhe ngritja në gishtërinjë të këmbëve para shkëputjes. Shkëputja e dyfishtë nuk është e lejuar.

Detyrat: subjekti kërcen sa më lartë që mundet me të dy këmbët dhe rënien duhet ta bëjë me të dy këmbët. Ekzekutohen dy deri në tri kërcime.

Vlerësimi: gjatësia e kërcimit matet nga distanca M1 deri tek distanca M2 e cila arrihet pas shkëputjes me rastin e arritjes së pikës më të lartë me maje të gishtërinjve..

Vlenë rezultati i kërcimit më të gjatë i cili shënohet në centimetra.

Rezultati në fletëtestin përkatës shënohet me saktësi 1 cm.



KËRCIM SË GJATI NGA VENDI

Me këtë test masim forcën eksplozive të muskujve të trupit.

Mjetet: Shkumësi, apo stilolapsat me ngjyrë, shiriti metalik në centimetra.


Të testuarit (nxënësit) janë përgatitur me veshje sportive. Fillimisht i testuari duhet të qëndroj para vijës shtytëse në drejtim të kërcimit në të cilën janë të shënuar centimetrat dhe janë të vendosur me të dy këmbët paralel.

Shkëputja kryhet nga vendi me të dy këmbët. Janë të lejuara lëvizjet e hovit me duar dhe ngritja në gishtërinjë të këmbëve para shkëputjes. Shkëputja e dyfishtë nuk është e lejuar.

Detyrat: subjekti kërcen sa më gjatë që mundet dhe rënien duhet ta bëjë me të dy këmbët. Ekzekutohen dy deri në tri kërcime.

Vlerësimi: gjatësia e kërcimit matet me distancën prej vijës së shtytjes e deri të gjurma më e afërt që e lenë pjesa e prapme e shputave, me rastin e rënies. Vlenë rezultati i kërcimit më të gjatë i cili shënohet në centimetra.

Rezultati në fletëtestin përkatës shënohet me saktësi 1 cm.



KËRCIM SË GJATI NGA VENDI

VRAPIM 20 METRA

Me këtë test masim shpejtësinë bazike.


Mjetet: Kohëmatës, (Kronometër) dhe flamuj ose kona për shënimin e startit dhe cakt.

Detyra: Subjekti qëndron së paku 20m para vijës së startit, në pozicionin e startit të lartë, pas së cilës subjekti përkulet para, me peshën në këmbën e përparme dhe fillon vrapimin dhe tenton që të arrijë shpejtësi maksimale të vrapimit para vijës së startit. Pasi të arrijë në vijën e startit ai duhet që të mbajë shpejtësinë maksimale deri sa të kalon edhe 20 metra prej vijës së startit deri te caku.

Startuesi është i vendosur në vijën e startit dhe në momentin kur startuesi jep shenjën, duke lëshuar dorën prej pozitës horizontale – poshtë, matësi i kohës e nisë matjen me kronometër dhe e ndalë atë kur subjekti e kalon me gjoks vijën e cakt.


Vlerësimi: matet koha prej startit deri te caku dhe rezultati i fituar shënohet në fletë testin përkatës me saktësi 0.10 sec.

Pozita e startit



Gjuajtja e topthave (1/2 kg) prej vendit në largësi

Ky test është mbajtur në poligonin sportiv brenda oborrit të shkollës në të cilën këta nxënës edhe i zhvillojnë aktivitetet e tyre sportive. Vija nga e cila është hedhur medicinballi 1/2kg është caktuar nga hulumtuesi e gjithashtu edhe është shpjeguar edhe mënyra e ekzekutimit të detyrës. Fillimisht hulumtuesi e ka demonstruar këtë lloj testi, ndërsa më pas të njëjtit test ju kanë nënshtruar një nga një të gjithë të testuarit. Rezultatet e arritura janë lexuar në decimetra dhe janë shënuar në fletorën e hulumtuesit.



Hedhja e topit të medicinballit 1/2kg në largësi

4.3.3 Përshkrimi i procedurave të matjes së variablave motorike situacionale

SHËRBIMI I TOPIT

Shërbimi i topit – në këtë test nxënësit i'u janë nënshtruar shërbimit shkollor e cila është egzekutuar nga zona e shërbimit dhe secili ka realizuar nga tre tentime. Me këtë rast hulumtuesi në fushën kundërshtare ka ndarë fushën në zona të caktuar dhe secilës zona i ka dhënë pikë dhe varësisht se në cilën zonë bie shërbimi, janë shënuar edhe pikët. Në këtë test nga tri tentime janë mbledhur pikët dhe janë shënuar në fletoren e hulumtuesit. Mjetet e nevojshme për këtë test janë fusha, rrejta, topi, etj.



	3	2
	4	2
	3	2

GJUAJTJA E TOPIT ME KËRCIM

Gjuajtja me kërcim- në këtë test nxënësit i'u janë nënshtruar gjuajtjes me kërcim nga zona IV siç njihet në sportin e volejbollit, ndërsa pasimi i topit është bërë nga zona III të cilin e ka bërë mësimdhënësi i lëndës. Secili nxënës ka realizuar nga tre tentime dhe vlerësimi është bërë në atë mënyrë që nëse gjuajtja ka rënë brenda vijave kufizuese të fushës kundërshtare është vlerësuar me një pikë dhe e kundëra, në rast se topi i gjuajtur nga ana e nxënësve ka rënë jashta vijave kufizuese ose në rrjetë, tentimi është vlerësuar me zero pikë.



Gjuajtja e topit nga zona IV

PRANIMI I TOPIT ME ÇEKAN

Pranimi i topit – është bërë nga zona VI me ç'rast nxënësit janë sygjeruar të vendosen në qëndrimin për pranim të topit. Secili nxënës ka bërë pranimin e tre topave të cilët i'u janë hedhur nga shërbimi dhe vlerësmi është bërë në atë mënyrë që nëse pranimi është bërë brenda vijave kufizuese dhe cili realisht ka mundur të pasohet, është vlerësuar me një pikë, ndërsa në rast të mos pranimit të mirë të topit është vlerësuar me zero pikë. Pikët e grumbulluara nga tre tentimet janë mbledhur edhe janë shënuar në fletoren e hulumtuesit.



Pranimi i topit nga zona VI

4.4 Metodat statistikore të përpunimit të rezultateve

Në bazë të qëllimit të parashtruar është zgjedhur edhe metodologjia e përpunimit të rezultateve:

Parametrat themelorë statistikorë:

- mesi aritmetik (Mean),
- rezultati minimal (Min.)
- rezultati maksimal (Max.)
- devijimi standard, (Std.Dev.)
- gabimi i mesit aritmetik, (St.Error)
- simetria e distribucionit (Skew)
- shtrirja e distribucionit (Kurt)
- korrelacioni sipas Pirsonit
- Vërtetimi i ndryshoreve në ndryshoret e aplikuara ndërmjet dy qendrave do të realizohen përmes T-testit
- Paraqitja grafike e rezultateve

5. REZULTATET DHE DISKUTIMI

5.1 Parametrat themelor statistikor

Tabela 1 – Parametrat themelor statistikor të varablave antropometrike dhe motorike të nxënësve femra të komunës se Lipjanit







	Min	Max	Mean	Std. Error	Std. Dev	Skew	Kurt
APESHA	41.00	71.00	53.35	1.22	7.70	.30	-.65
ALARTE	150.00	174.00	162.68	.99	6.28	-.26	-.62
AGJSHP	21.00	25.00	23.33	.18	1.12	-.11	-.62
AGJAKR	146.00	180.00	162.13	1.10	6.97	.18	.08
MKLVEN	19.00	34.00	26.50	.64	4.03	.24	-.78
MKGJVE	100.00	170.00	120.30	2.73	17.26	.97	.69
MVR20M	3.99	5.39	4.76	.06	.38	-.26	-1.12
MGT500	19.40	24.50	22.02	.25	1.57	-.23	-1.31
MSSHTO	2.00	10.00	5.35	.32	2.02	.53	-.40
MSGJKE	.00	3.00	2.03	.13	.80	-.36	-.50
MSPRTO	1.00	3.00	2.15	.12	.77	-.27	-1.24

Në tabelën 1 janë paraqitur parametrat themelor statistikor të variablave antropometrike dhe motorike te femrat. Mesatarja e peshës trupore te femrat është 53.35kg, kurse lartësia trupore mesatare është 162.68cm. Femra me lartësi të trupit më të lartë në komunën e Lipjanit ka qenë 174 centimetra. Gjatësia e shputës mesatarisht ka qenë 23.33 cm, ndërsa ajo e krahëve të shtrirë mesatarisht 162.13cm.

Nxënëset kanë kërcyer lartë nga vendi mesatarisht 26.50cm. Kërcimi së gjati nga vendi mesatarisht ka pasur vlera 120.30cm, ndërsa vrapimi 20 metra 4.76 sekonda.

Të gjitha variablat kanë treguar shpërndarje në kufi të normales këtë e tregojnë parametrat e asimétrisë dhe ata të shtrirjes së distribucionit.

Paraqitja grafike e shpërndarjes së rezultateve femrat - Lipjan










Tabela 2 – Parametrat themelor statistikor të varablave antropometrike dhe motorike të nxënësve meshkuj të komunës së Lipjanit

	Min	Max	Mean	Std. Error	Std. Dev	Ske ë	Kurt
APESHA	35.00	96.00	54.75	2.00	12.65	1.25	2.54
ALARTE	151.00	190.00	169.05	1.51	9.54	.15	-.65
AGJSHP	23.00	28.00	25.66	.21	1.33	-.16	-.64
AGJAKR	147.00	189.00	169.41	1.65	10.47	-.07	-.80
MKLVEN	22.00	60.00	33.98	1.31	8.27	.79	1.19
MKGJVE	123.00	210.00	156.20	3.17	20.06	.63	.29
MVR20M	3.20	4.87	4.07	.05	.33	-.06	1.19
MGT500	27.80	44.20	34.81	.78	4.94	.27	-1.10
MSSHTO	.00	3.00	2.23	.12	.77	-.77	.34
MSGJKE	2.00	10.00	6.10	.30	1.89	-.01	-.75
MSPRTO	1.00	3.00	2.30	.12	.76	-.57	-1.01







Tabela 2 paraqet parametrat themelor statistikor të variablave antropometrike dhe motorike te meshkujt nga shkolla e komunës së Lipjanit. Lartësia trupore mesatare ka qenë 169.05cm, kurse pesha mesatare e kësaj mostre është 54.75kg, Gjatësia e krahëve të shtrirë është e ngjashme me atë të lartësisë së trupit si edhe në hulumtimet e autorëve tjerë.

Gjatësia e shputës mesatarisht ka qenë 23.33 cm, ndërsa ajo e krahëve të shtrirë mesatarisht 162.13cm.

Nxënëset kanë kërcyer lartë nga vendi mesatarisht 26.50cm. Kërcimi së gjati nga vendi mesatarisht ka pasur vlera 120.30cm, ndërsa vrapimi 20 metra 4.76 sekonda.

Shumica e variablave kanë treguar shpërndarje në kufi të normales, megjithatë tek pesha e trupit parametrat e shtritjes tejkalojnë kufirin normal të shtrirjes së distribucionit, vlerat e Kurt 2.54 tregojnë se shumë nxënës të kësaj mostre kanë pas peshë shumë të përafërt.

Paraqitja grafike e shpërndarjes së rezultateve meshkujt - Lipjan










Tabela 3 – Parametrat themelor statistikor të varablave antropometrike dhe motorike të nxënësve femra të komunës së Vushtrrisë







	Min	Max	Mean	Std. Error	Std. Dev	Ske ë	Kurt
APESHA	38.00	81.00	51.70	1.36	8.61	1.19	2.79
ALARTE	145.50	173.00	162.01	.98	6.17	-.67	.30
AGJSHP	22.00	26.00	24.35	.16	1.00	-.37	.00
AGJAKR	140.00	175.00	161.95	1.03	6.50	-.79	2.19
MKLVEN	24.00	37.00	30.98	.48	3.03	-.34	-.03
MKGJVE	105.00	175.00	144.75	2.44	15.44	-.21	-.16
MVR20M	3.66	4.48	4.10	.03	.21	.08	-.70
MGT500	18.50	26.40	21.88	.32	2.05	.25	-.88
MSSHTO	2.00	12.00	8.33	.47	2.98	-.26	-1.16
MSGJKE	.00	3.00	2.28	.13	.85	-1.11	.79
MSPRTO	.00	3.00	1.78	.17	1.10	-.38	-1.15

Në tabelën 3 janë paraqitur parametrat themelor statistikor të variablave antropometrike dhe motorike te femrat e komunës së Vushtrrisë. Mesatarja e peshës trupore te femrat është 51.70kg, kurse lartësia trupore mesatare është 162.01cm. Gjatësia e shputës mesatarisht ka qenë 24.35 cm, ndërsa ajo e krahëve të shtrirë mesatarisht 161.95cm.

Nxënëset kanë kërcyer lartë nga vendi mesatarisht 30.98cm. Kërcimi së gjati nga vendi mesatarisht ka pasur vlera 144.75cm, ndërsa vrapimi 20 metra 4.10 sekonda.

Sikurse te nxënëst meshkuj nga Lipjani edhe te nxënëset femra të Vushtrrisë te variablat pesha e trupit dhe gjatësia e krahëve të shtrirë kemi ngritje të kurbës së shpërndarjes jashtë kufive të normales. Vlerat e Kurt janë 2.79 te pesha e trupit dhe 2.19 te gjatësia e krahëve të shtrirë.

Paraqitja grafike e shpërndarjes së rezultateve femrat - Vushtri










Tabela 4 – Parametrat themelor statistikor të varablave antropometrike dhe motorike të nxënësve meshkuj të komunës së Vushtrrisë

	Min	Max	Mean	Std. Error	Std. Dev	Ske ë	Kurt
APESHA	39.00	82.00	55.45	1.59	10.07	.56	.09
ALARTE	153.50	189.50	169.25	1.16	7.31	.15	.77
AGJSHP	23.50	28.50	26.43	.19	1.21	-.12	-.10
AGJAKR	151.00	192.00	172.68	1.32	8.33	-.19	.43
MKLVEN	32.00	51.00	41.18	.84	5.33	-.01	-.88
MKGJVE	130.00	235.00	193.53	3.57	22.60	-.28	.59
MVR20M	3.18	3.90	3.52	.03	.20	.07	-.56
MGT500	27.60	46.50	38.17	.79	5.00	-.45	-.70
MSSHTO	4.00	12.00	9.15	.45	2.85	-.54	-1.22
MSGJKE	1.00	3.00	2.33	.13	.80	-.67	-1.09
MSPRTO	.00	3.00	1.85	.17	1.10	-.54	-1.00

Tabela 4 paraqet parametrat themelor statistikor të variablave antropometrike dhe motorike të nxënësve meshkuj nga Vushtrria. Peshat trupore minimale është 39 kg, derisa ajo maksimale është 82 kg, por mesatarja e meshkujve të kësaj mostre është 55.45kg.







Vrapimi 20 metra ka mesatare 3.52 sekonda, ndërsa fëmijët kërcejnë së gjati nga vendi mesatarisht 193.53 centimetra.






Gjuajtjen e topit 500 gram mesatarisht e kanë realizuar me 38.17 metra. Kërcimi së larti nga vendi mesatarisht është realizuar me diferencë në shkaputje prej 41.18 centimetra.

Variablat situacionel - gjuajtjet e precizitetit

Të gjitha variablat kanë treguar shpërndarje të kurbës në kufi të normales.

Paraqitja grafike e shpërndarjes së rezultateve meshkujt - Vushtri





5.2 Korrelacionet ndërmjet ndryshoreve antropometrike, motorike dhe motorike situacionale

Tabela 5. Korrelacionet e ndryshoreve antropometrike të nxënësve – femra

	APESHA	ALARTE	AGJSHP	AGJAKR
APESHA	1.00			
ALARTE	.41**	1.00		
AGJSHP	.36**	.56**	1.00	
AGJAKR	.40**	.87**	.61**	1.00

Tabela 6. Korrelacionet e ndryshoreve motorike dhe specifike të nxënësve – femra

	MKLVEN	MKGJVE	MVR20M	MGT500	MSSHTO	MSGJKE	MSPRTO
MKLVEN	1.00						
MKGJVE	.39**	1.00					
MVR20M	-.66**	-.50**	1.00				
MGT500	.13	.13	-.02	1.00			
MSSHTO	.12	.45**	-.43**	.17	1.00		
MSGJKE	.15	.23*	-.19	.31**	.42**	1.00	
MSPRTO	-.27*	-.11	.11	.29**	.33**	.37**	1.00

Të gjitha variablat antropometrike në tabelën 5 kanë realizuar korrelacione statistikisht të vlefshme ndërmjet vete. Korrelacioni më i lartë është ndërmjet lartësisë së trupit dhe gjatësisë së krahve të shtrirë.

Në tabelën 6 kemi korelacionet e variablave motorike dhe motorike specifike. Kërcimi së gjati nga vendi ka lidhshmëri me shumicën e variablave motorike por edhe me dy variablat e motorikës specifike. Korrelacione të ngjashme ka realizuar edhe variablat që masinë shpejtësinë e vrapimit 20 metra dhe kërcimin së larti nga vendi.

Te variablat e motorikes situacion kemi korrelacione të vlefshme ndërmjet të tri variablave.

*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed). .22

** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed). .29

Tabela 7. Kroskorrelacionet e ndryshoreve antropometrike, motorike dhe specifike të nxënësve – femra

	APESHA	ALARTE	AGJSHP	AGJAKR
MKLVEN	-.05	.13	.45**	.21
MKGJVE	.08	.13	.27*	.10
MVR20M	.20	.04	-.37**	.06
MGT500	.54**	.30**	.16	.30**
MSSHTO	.11	.06	.26*	.09
MSGJKE	.26*	.31**	.35**	.30**
MSPRTO	.38**	.09	-.07	.10

Në tabelën 7 janë paraqitur korrelacionet ndërmjet dy hapësirave asaj antropometrike dhe motorike – specifike. Gjatësia e shputës ka treguar korrelacione me shumicën e variablave motorike, por korrelacionin më të larët e ka arritur me kërcimin së larti nga vendi .45. Andaj mund të themi se nxënëset me shputë më të madhe të këmbës kanë qenë më të mirë në variablat motorike ku është kërkuar shpejtësia apo forca eksplozive. Gjithashtu edhe variabla e gjuajtjes së topit 500 gram ka treguar lidhshmëri të shumicën e variablave antropometrike.

Gjuajtja e topit me kërcim ka realizuar korrelacione të vlefshme me të gjitha variablat antropometrike të kjo mostër.

*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed). .22

** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed). .29

Tabela 8. Korrelacionet e ndryshoreve antropometrike te nxënësit – meshkuj

	APESHA	ALARTE	AGJSHP	AGJAKR
APESHA	1.00			
ALARTE	.60**	1.00		
AGJSHP	.49**	.70**	1.00	
AGJAKR	.60**	.92**	.77**	1.00

Tabela 9. Korrelacionet e ndryshoreve antropometrike te nxënësit – meshkuj

	MKLVEN	MKGJVE	MVR20M	MGT500	MSSHTO	MSGJKE	MSPRTO
MKLVEN	1.00						
MKGJVE	.82**	1.00					
MVR20M	-.69**	-.77**	1.00				
MGT500	.20	.32**	-.27*	1.00			
MSSHTO	.54**	.73**	-.68**	.45**	1.00		
MSGJKE	-.26*	-.42**	.47**	-.18	-.60**	1.00	
MSPRTO	.08	.02	.05	.11	.12	.31**	1.00

Sikurse edhe në punimet e autorëve të tjerë këto variabla antropometrike të trajtuara kanë realizuar korrelacione statistikisht të vlefshme ndërmjet vete (tabela 8).

Në tabelën 9 janë paraqitur lidhshmëritë e variablave motorike dhe specifike. Kërcimi së gjati ka treguar korrelacione me shumicën e variablave tjera mororike dhe specifike. Korrelacioni më i lartë është realizuar ndërmjet kërcimit së gjati nga vendi dhe kërcimit së larti nga vendi me koeficient .82.

Pothuajse të gjitha variablat të cilat masin forcën eksplozive dhe shpejtësinë kanë treguar lidhshmëri ndërmjet vete.

*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed). .22

** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed). .29

Tabela 10. Korrelacionet e ndryshoreve antropometrike te nxënësit – meshkuj

	APESHA	ALARTE	AGJSHP	AGJAKR
MKLVEN	.04	.32**	.22*	.40**
MKGJVE	.06	.27*	.35**	.44**
MVR20M	.06	-.13	-.24*	-.22*
MGT500	.41**	.36**	.55**	.43**
MSSHTO	.09	.14	.40**	.30**
MSGJKE	-.01	.15	-.04	-.01
MSPRTO	-.01	.11	.12	.08

Tabela 10 paraqet korrelacionet ndërmjet dy hapësirave asaj antropometrike dhe motorike – specifike tek meshkujt. Gjatësia e krahëve të shtrirë ka treguar korrelacione me të gjitha variablat motorike, por edhe me shërbimin e topit si variabël specifike.

Gjatësia e shputës po ashtu ka treguar lidhshmëri me variablat motorike të cilat kryesisht shprehin forcën eksplozive dhe shpejtësinë e vrapimit.

Variabla e vetme e motorikës specifike e cila ka korrelacione të vlefshme me variablat antropometrike është shërbimi i topit. Andaj mund të themi që te kjo mostër e meshkujve dimensionet antropometrike nuk kanë lidhshmëri me variablat motorike specifike.

*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed). .22

** . Correlation is significant at the 0.01 level (2-tailed). .29

5.3 Ndryshimet ndërmjet grupeve për variablat antropometrike, motorike dhe specifike

Tabela 11. Ndryshimet ndërmjet nxënësve femra të Lipjanit dhe të Vushtrrisë te variablat antropometrike, motorike dhe specifike.

	Independent Samples Test						
	Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means				
	F	Sig.	t	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	Std. Error Difference
APESHA	.03	.86	.90	78	.37	1.65	1.83
ALARTE	.21	.65	.48	78	.64	.66	1.39
AGJSHP	.88	.35	-4.32	78	.00	-1.03	.24
AGJAKR	.89	.35	.12	78	.91	.18	1.51
MKLVEN	4.36	.04	-5.61	78	.00	-4.48	.80
MKGJVE	.16	.69	-6.68	78	.00	-24.45	3.66
MVR20M	18.89	.00	9.50	78	.00	.65	.07
MGT500	2.13	.15	.36	78	.72	.15	.41
MSSHTO	10.10	.00	-5.22	78	.00	-2.98	.57
MSGJKE	.83	.37	-1.36	78	.18	-.25	.18
MSPRTO	7.04	.01	1.77	78	.08	.38	.21

Në tabelën 11 janë paraqitur ndryshimet ndërmjet nxënësve femra të Lipjanit dhe të Vushtrrisë te variablat antropometrike, motorike dhe specifike.

Nëse krahasojmë dallimet ndërmjet nxënësve femra të komunës së Lipjanit dhe komunës së Vushtrrisë vërejmë dallimet në statistika të vlefshme të këto variabla:

- Gjatësia e shputës te femrat e Vushtrrisë është më e madhe
- Në variablat kërcim së gjatë nga vendi, kërcim së larti nga vendi dhe vrapim 20 metra nxënëset e Vushtrrisë kërcen më shumë, por edhe vrapojnë më shpejtë.
- Te variablat e motorikës specifike konkretisht te variabla shërbimi i topit nxënëset nga komuna e Vushtrrisë janë më të sakta në shërbim.

Në variablat tjera nuk kemi ndryshime të vlefshme statistikore.

Tabela 12. Ndryshimet ndërmjet nxënësve meshkuj të Lipjanit dhe të Vushtrrisë të variablat antropometrike, motorike dhe specifike.

	Independent Samples Test						
	Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means				
	F	Sig.	t	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	Std. Error Difference
APESHA	.57	.45	-.27	78	.78	-.70	2.56
ALARTE	4.79	.03	-.11	78	.92	-.20	1.90
AGJSHP	.67	.42	-2.68	78	.01	-.76	.28
AGJAKR	4.03	.05	-1.54	78	.13	-3.26	2.12
MKLVEN	5.17	.03	-4.63	78	.00	-7.20	1.56
MKGJVE	.28	.60	-7.81	78	.00	-37.33	4.78
MVR20M	3.28	.07	9.02	78	.00	.55	.06
MGT500	.00	.98	-3.03	78	.00	-3.36	1.11
MSSHTO	67.98	.00	-14.83	78	.00	-6.93	.47
MSGJKE	30.38	.00	11.63	78	.00	3.78	.32
MSPRTO	4.58	.04	2.13	78	.04	.45	.21

Tabela 12 paraqet ndryshimet ndërmjet nxënësve meshkuj të Lipjanit dhe të Vushtrrisë të variablat antropometrike, motorike dhe specifike. Si mund të vërejmë në tabelë ndryshimet e nxënësve të Vushtrrisë dhe të Lipjanit në variablat motorike dhe specifike janë të dukshme dhe statistikisht të rëndësishem tek të gjitha variablat. Madje këto ndryshime janë shumë të larta.

Te variablat antropometrike kemi vetëm një ndryshim të vlefshëm ndërmjet nxënësve të këtyre dy komunave. Nxënësit e komunës së Vushtrrisë kanë gjatësi të shpëtës më të madhe sa ata të komunës së Lipjanit. Në variablat tjera antropometrike nuk ka ndryshime statistikisht të vlefshme.

Tabela 13. Ndryshimet ndërmjet nxënëseve femra dhe meshkuj të dy komunave së bashku Lipjan dhe Vushtrri për variablat antropometrike, motorike dhe specifike.

	Independent Samples Test						
	Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means				
	F	Sig.	t	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	Std. Error Difference
APESHA	4.44	.04	-1.65	158	.10	-2.58	1.56
ALARTE	6.70	.01	-5.81	158	.00	-6.81	1.17
AGJSHP	.20	.66	-11.17	158	.00	-2.21	.20
AGJAKR	11.68	.00	-6.91	158	.00	-9.01	1.30
MKLVEN	23.06	.00	-8.92	158	.00	-8.84	.99
MKGJVE	8.67	.00	-10.84	158	.00	-42.34	3.90
MVR20M	2.42	.12	9.63	158	.00	.64	.07
MGT500	95.74	.00	-23.54	158	.00	-14.54	.62
MSSHTO	19.16	.00	2.05	158	.04	1.15	.56
MSGJKE	80.89	.00	-7.31	158	.00	-2.06	.28
MSPRTO	.01	.91	-.74	158	.46	-.11	.15

Në tabelën 13 janë paraqitur ndryshimet ndërmjet nxënëseve femra dhe meshkuj të dy komunave së bashku Lipjan dhe Vushtrri për variablat antropometrike, motorike dhe specifike.

Femrat dhe meshkujt dallojnë pothuajse në të gjitha variablat e aplikuara në këtë punim, përveç në peshën trupore dhe pranimit të topit. Të gjitha dallimet janë në të mirë të meshkujve përveç te variabla gjuajtja me kërcim ku femrat kanë treguar rezultat më të mirë në këtë test se meshkujt.

Dallimi më i lartë ndërmjet meshkujve dhe femrave është te variabla e gjuajtjes së topit 500 gram.

Edhe dallimi në kërcim së gjati është shumë i madhe me e krahasuar me mesataret e grupeve, rreth 42.34 centimetra meshkuj kërcenjë mesatarisht më shumë se femrat.

5.4 Analiza e hipotezave të parashtruara

Hipotezat e parashtruar në bazë të rezultateve të cilat kanë dalë nga metodat statistikore të aplikuara në këtë punim do të analizohen.

H₁ – Hipoteza e parë “Pres që do të paraqiten lidhmëri të rëndësishme në mes variablave antropometrike dhe motorikës bazike”, është vërtetuar dhe si e tillë mund të pranohet, kemi pasur korrelacione në shumicën e variablave.

H₂ – Hipoteza e dytë “Nuk presim se do të paraqiten raporte të rëndësishme korrelative ndërmjet antropometrisë dhe motorikës situacionale”, është vërtetuar pjesërisht dhe si e tillë mund të pranohet, janë realizuar megjithatë disa korrelacione të vlefshme ndërmjet këtyre hapësirave.

H₃ – Hipoteza e tretë “Presim ndryshime të vogla të antropometrisë dhe motorikës bazike të nxënësve në mes të dy shkollave të qyteteve (Vushtrri dhe Lipjan)”, është vërtetuar pjesërisht dhe si e tillë mund të pranohet, kemi pasur disa dallime të vogla ndërmjet dy shkollave të qyteteve në variablat antropometrike, por kemi pasur dallime të mëdha në variablat motorike.

6. PËRFUNDIMI

Në mostrën prej 160 nxënësve në ndarë nga 80 nxënës (40 femra dhe 40 meshkuj) për komunën e Lipjanit dhe 80 nxënës (40 femra dhe 40 meshkuj) në komunën e Vushtrrisë është trajtuar hapësira antropometrike (me 4 variabla), motorike (4 variabla) dhe situacionale (3 variabla), janë shqyrtuar lidhmëritë brenda dhe ndërmjet hapësirave, dhe raportet e këtyre hapësirave me variablat e motorikës situacionale.

Nga rezultatet e fituara nga statistika përshkruese kemi vërejtur shpërndarjen e rezultateve të ndërtimit trupor dhe aftësitë motorike të këtyre nxënësve. Të gjitha variablat tjera të aplikuara në këtë punim kanë treguar shtrirje afër suazave normale të rezultateve. Përrjashtim bënë vetëm variablat e peshës trupore dhe gjatësisë së krahëve shtrirë të cilat patën distribucion apo kurbë të ngritur të rezultateve. Në këto variabla shumë nxënës kanë treguar rezultate të përafërta dhe kështu janë pozicionuar afër vlerave të mesatares aritmetike.

Lidhmëritë e hapësirave ndërmjet vete kanë qenë të dukshme tek të dy hapësirat, si të variablave antropometrike ashtu edhe ato motorike. Ndërsa, lidhshmëritë kros korrelative të dy hapësirave kanë qenë më pak të shprehura te kjo mostër e hulumtimit. Nga variablat e motorikës situacionale kanë realizuar lidhshmëri më të shprehur me variablat e motorikës bazike se me përmasat antropometrike. Nga kjo mund të theksojmë se aftësitë fizike kanë lidhshmëri më të shprehur se ato morfologjike.

Nxënësit dhe nxënëset nga komuna e Vushtrrisë janë tregura më superior ndaj nxënësve të Lipjanit në variablat motorike dhe situacionale, ndërsa dallimet ndërmjet gjinive janë dushkëm të shprehura në favor të meshkujve.

Konkluzion i këtij punimi është se gjatë seleksionimit të fëmijët me sportin e volejbollit duhet më shumë të orientohemi parimisht në parametrat motorik të fëmijëve e pastaj edhe në ata antropometrik. Çdo herë duhet të marrim për bazë kërkesat të cilat i nevojiten sportit të volejbollit.

6. CONCLUSION

In the sample of the 160 pupils divided by 80 pupils (40 girls and 40 boys) from the municipality of Lipjan and 80 pupils (40 girls and 40 boys) from the municipality of Vushtrri anthropometric (with 4 variables), motoric (4 variables) and situational (3 variables) space were treated, correlation within and between those spaces and relationships of these spaces with situational motoric variables were considered.

From the results obtained from descriptive statistics, we have noticed the distribution of body building results and motor skills of these pupils. All variables applied in this work have shown distribution near normal. Only the variables of body weight and the length of stretched arms that had dispersion or elevated output curve made exceptions. In these variables, many students have shown close results and are thus positioned close to the values of arithmetic average.

Correlation between anthropometric and motoric variables have been very visible. Meanwhile, the relationship cross correlation of two spaces has been less expressed in this sample of research. From the situational motoric variables they have made more emphasized connectivity with the basic motor variables than the anthropometric dimensions. From this we can emphasize that physical skills have more pronounced connectivity than morphological ones.

Pupils, boys and girls of the municipality of Vushtrri are superior to Lipjan pupils in motoric and situational variables, while differences between genders are expressed in favor of boys.

The conclusion of this work is that in the selection of children for sport of volleyball we should be more oriented in principle to the motoric parameters of children and then for those anthropometric ones. Every time we need to get the basic requirements that are needed for sport of volleyball.

7. LITERATURA

1. B.Beters: Elementarna Statistika, Zagreb, 1968
2. Milanović. D. : Latente Strukture nekih testova za procenu faktora eksplozivni snage, Kineziologija 1-2, Zagreb, 1981.
3. Peçiç. A.: Interkorelacia i kros korelacia motorski funkcionalnih karakteristika i motorickih sponsobnosti, kineziologija 1-2. Zagreb 1981.
4. Dr. F. Çitaku, relacionet e disa dimenzioneve motorike me grup sportistesh të të tri disiplinave sportive. “Elan”, nr.11, Prishtinë, 1984.
5. Dr. Rushiti. H. “Testimet e ushtrimeve fizike
6. 1.Musa Selimi 2.Bahri Gjinovci: Volejball – Metodologjia e të mësuarit. Coaches Manual – Fivb (I perkthyer), 2014.
7. 1.Naser Rashiti, 2.Musa Selimi, 3.Hazir Salihu : “Analiza e disiplinave strukture te shtategarshit te moshes senior dhe junior”. “Studime Sportive” Tiranë, 4/2004
8. M.Selimi autor i dyte Vleresimi i Aftesive lokomotore situacionale ne procesin e edukimit fizik te femijet 11-14 vjeçar International journey sport Ljubljana 2009
9. M.Selimi autor i trete:Razvoj karakteristike motoricke sponsobnosti na rezultate trcanja nastavni planova i programa fizickog vaspitanja, Revista shkencore “MISLI”2009,Fakultet sporta i fizickog vaspitanja.Novi Sad .